



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:159222
Datë: 12.02.2024
Numri i dokumentit: 05312939

PA1.nr.101/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Pergjithshem, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Skender Çoçaj, anëtarë, me praktikantin gjyqësor Arben Arifi, si procesmbajtës në lëndën penale ndaj të akuzuarit Sh.G., nga Peja, për shkak të veprës penale, Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-se dhe veprës penale Asgjesimi apo demtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-se, për të vendosur sipas ankesës së të akuzuarit Sh.G., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.809/2020 të datës 06.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 05 Shkurt 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesërishëm të ankesës së të akuzuarit Sh.G., **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.809/2020 i datës 06.11.2023, përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarit për veprën penale, Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-se për të cilën është shpallur fajtor, i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, ndërsa për veprën penale Asgjesimi apo demtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-se, për të cilën është shpallur fajtor i shqipton dënimin me gjobe në shumë prej 200 (dyqind) euro, e në pajtim me nenin 76 të KPRK-se i shqipton dënimin unik me gjobe në shumë prej 500 (peseqind) euro, e të cilën gjobe është i obliguar që ta paguaje në afat prej 3 muaj pas plotfuqishmerisë së aktgjykimit. Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin e shqiptuar me gjobe, atëherë i njëjti do të i shëndrrohet në dënim me burgim, ku për qdo 20 euro të gjobes do të i llogaritet 1 ditë burgim.

Në pjesën tjetër aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë mbetet i pandryshuar.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Peje P.nr.809/2020 të datës 06.11.2023, i akuzuari Sh.G., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale, Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-se, për të cilin i është shqiptuar dënimi me gjobe në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, si dhe për veprën penale Asgjësimi apo demtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-se, për të cilin i është shqiptuar dënimi me gjobe në shumë prej 500 (pesëqind) euro, e në pajtim me nenin 76 të KPRK-se, i është shqiptuar dënimi unik me gjobe në shumë prej 1100 (njëmijë e njëqind) euro, e të cilin gjobe është obliguar që ta paguajë në afat prej 3 muaj pas plotfuqishmerisë së aktgjykimit.

Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobe, i njëjti do të i shëndrrohet në dënim me burgim, ku për çdo 20 euro të gjobes do të i llogaritet një ditë burgim.

I akuzuari është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogaritës së fundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumen prej 20 (njezet) Euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmerisë së aktgjykimit.

I demtuari A.B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankese ka ushtruar :

I akuzuari Sh.G., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkalles së parë të ndryshohet, dhe të akuzuarit për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor dënimi i shqiptuar me gjobe të i kushtëzohet, e me të cilin dënim do të arrihej qëllimi i dënimit i parapare me nenin 38 të KPRK-se.

Prokurori i Apelit të Kosovës, duke u shkjaruar përkitazi me ankesën e të akuzuarit Sh.G., me shkresën e vet PPA.II.nr. 110/2024 të datës 22.01.2024 ka propozuar që Gjykata e Apelit të Kosovës, ankesën e të akuzuarit ta refuzojë si të pa bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkalles së parë të vertetohet.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me nenin 390 paragrafi 1 të KPPRK-se, në të cilin nuk i ftoi palet ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me dënim me gjobe dhe njoftimi i paleve nuk është i obliguar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të akuzuarit, dhe gjeti se :

- Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të Kosovës të njëjtin e shqyrtoi në këtë aspekt sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPRK-së dhe konstatoi se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

As gjendja faktike nuk ka qenë objekt shqyrtimi, ngase i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar të datës 16.10.2023 në bazë të nenit 242 të KPRK-së ka pranuar fajësinë për veprat

penale për të cilat është akuzuar, i cili pranimit është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari. Pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet që përmban aktakuza dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike del që në rastin konkret drejtë është aplikuar edhe ligji penal.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, i akuzuari Sh.G., me ankesë pretendon se Gjykata e shkalles se pare me rastin e shqiptimit te denimit unik me gjobe ne shume prej 1100 (njemije e njeqind) euro, nuk i ka vleresuar drejte dhe ne menyre te duhur rrethanat lehtesuese si faktin se i akuzuari ne shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajesine per veprat penale te kryera, se i njejti eshte ne gjendje te skajshme te varferise, se i ka vdeke prindi ne moshe te re, jeton nga ndihma sociale te cilen e merr nena e tij, eshte mbajtes i 8 anetareve te familjes, dhe se nga kjo gjendje nuk eshte ne mundesi qe te paguaje denimin aq te larte te shqiptuar me gjobe, e sikur keto rrethana te ishin vleresuar ne menyre te duhur eshte dashur qe te akuzuarit te i shqiptohet nje denim i kushtezuar nga ana e Gjykates se shkalles se pare, e me te cilin denim do te arrihej qellimi i denimit i parapare me nenin 38 te KPRK-se, andaj ka propozuar qe ankesa e te akuzuarit te aprovet si e bazuar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit e Kosovës vleresoi pretendimet ankimore te akuzuarit lidhur me vendimin mbi denimin, dhe konstatoi se te njejtat jane pjeserisht te bazuara e sidomos edhe nga fakti se i akuzuari eshte i gjendjes se veshtire ekonomike, jeton nga ndihma sociale, eshte mbajtes i familjes 8 anetaresh dhe ekzistencen e siguron nga mbledhja dhe shitja e kanaqeve, se veprat penale jane kryer ne vitin 2020, e per te cilat arsye Gjykata e Apelit e Kosoves e ndryshoi aktgjykimin si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi, me bindje se edhe me denimin e ndryshuar do te arrihet qellimi i denimit i parapare me nenin 38 te KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryeresit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tij, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 403 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr. 101/24 më 05.02.2024

Procesmbajtës
Arben Arifi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetar i kolegjit,
Ferit Osmani

Skender Çoçaj